



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“Kujtesa Net” Sh.p.k.  
Rr. Pashko Vasa nr.18  
Prishtinë

Vendimi LIC/CO-CIMC: 2008/04  
Ref: 0805/0712/CIMC/II

### **VENDIM**

*lidhur me aplikacionin për licencë të operatorit kabllorë “Kujtesa Net” Sh.p.k -  
Prishtinë, Gjakovë, Prizren, Gjilan, Pejë, Vushtrri, Fushë Kosove.*

---

#### **Fakte**

1. Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media (KPM), duke vepruar në bazë të Nenit 2.5 dhe Nenit 11 të Ligjit për KPM-në Nr. 02/L-15 ka nxjerr Rregulloren e Distribimit Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë (CIMC 2007/04) e cila ka hyrë në fuqi më datë 06 korrik 2007.
2. Në bazë të Nenit 5 të Rregullores CIMC 2007/04, operatorët aktivë kabllor kanë qenë të obliguar të regjistrohen një muaj pas miratimit të kësaj rregulloreje, ndërsa tre muaj më vonë kanë qenë të obliguar të aplikojnë për licencë të KPM-së.
3. Më 17 gusht 2007 Operatori kabllor “Kujtesa Net” Sh.p.k., është regjistruar në zyrën e KPM-së si operator kabllor aktiv i cili operon nw qytetet: Prishtinë, Gjakovë, Prizren, Gjilan, Pejë, Vushtrri, Fushë Kosovë, ndërsa ka aplikuar për licencë të KPM-së për operator kabllor më 6 shkurt 2008.

#### **Arsyetim**

4. Në pajtim me Nenin 5 të Rregullës CIMC 2007/04 operatori kabllor “Kujtesa Net” Sh.p.k. ka paraqitur të dhëna të mjaftueshme për regjistrim në KPM si operator kabllor aktiv.

5. Në pajtueshmëri me Nenin 6 të Rregullës CIMC 2007/04 operatori kabllor “Kujtesa Net” Sh.p.k. ka paraqitur në aplikacionin e tij të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së për operator kabllor.
6. Me Rregulloren për Distribuim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë nuk përcaktohet numri i kanaleve se sa duhet të përmbajë lista e pakos programore për një operator kabllor, prandaj Këshilli i KPM-së vlerëson se një operator kabllor mund të licençohet edhe me një numër minimal të programeve nëse ai posedon marrëveshjet valide për ritransmetimin e atyre programeve.
7. Operatori kabllorë “Kujtesa Net” Sh.p.k. do të ketë të drejtë të bart në pakon e tij vetëm programet televizive për të cilat posedon marrëveshje për ritransmetim të kanaleve përmes rrjetit kabllor.
8. Nëse pas marrjes së licencës, operatori kabllor “Kujtesa Net” Sh.p.k. siguron marrëveshje shtesë/të reja për ritransmetimin e programeve në rrjetin kabllor, KPM, pas pranimit të kontratave të reja, do të zgjerojë listën e programeve për të cilat e ka licencuar. Operatori kabllor “Kujtesa Net” Sh.p.k. obligohet t’i ofrojë KPM-së të gjitha marrëveshjet e reja, sapo t’i ketë siguruar ato.
9. KPM vlerëson se “Kujtesa Net” Sh.p.k. ka paraqitur aplikacionin brenda afatit të përcaktuar nga ana e Këshillit të KPM-së në pajtim me kriteret e përcaktuara me Rregulloren CIMC 2007/04.
10. Prandaj, KPM vlerëson se në bazë të nenit 6 të Rregullores CIMC 2007/04 operatori kabllor “Kujtesa Net” Sh.p.k. ka përmbushur kriteret për kualifikim për licencë të KPM-së.

### Vendim

11. KPM konkludon se “Kujtesa Net” Sh.p.k. ka aplikuar për licencë të KPM-së dhe ka ofruar të gjitha të dhënat e nevojshme për të ofruar shërbime të programeve kabllore përmes sistemit kabllor në: Prishtinë, Gjakovë, Prizren, Gjilan, Pejë, Vushtri, Fushë Kosovë .
12. KPM vendos që operatorit kabllor “Kujtesa Net” Sh.p.k., i cili operon në Prishtinë, Gjakovë, Prizren, Gjilan, Pejë, Vushtri, Fushë Kosovë , t’i lëshoj licencën e KPM-së për të ofruar përmes sistemit kabllor shërbime të programeve kabllore për të cilat posedon marrëveshje për ritransmetim të kanaleve përmes rrjetit kabllor.
13. Në bazë të Nenit 3.2 të Rregullores për Distribuim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë, licenca e operatorit kabllor “Kujtesa Net” Sh.p.k. do të jetë valide për një periudhë prej dhjetë (10) vitesh, me mundësi vazhdimi nga ana e KPM-së.

14. Në pajtueshmëri me Nenin 10 të Rregullores CIMC Nr. 2007/4, çdo operator kabllor duhet të paguajë taksën vjetore. Niveli i taksës vjetore për licencim të Operatorëve Kabllorë është i përcaktuar me Nenin 3.1 të Vendimit për Nivelin, Mënyrën e Përcaktimit të Pagesës së Takës për Licencim të Operatorëve Kabllor dhe Ofruesve të Shërbimeve të Programeve përmes Kabllos (CIMC 2007/05).
15. Në pajtueshmëri me Nenin 6.2 të Vendimit (CIMC 2007/05), operatori kabllor "Kujtesa Net" Sh.p.k. duhet ta paguaj taksën e parë vjetore për licencë jo më vonë se 14 ditë pas pranimit të Licencës.

### Lëshimi i Vendimit

16. Këtë vendim e lëshon Këshilli i KPM-së.

A. Guri  
Argjentina Grazhdani  
Kryesuese e Këshillit të KPM-së.

29/05/08  
datë

### Vërtetim

Me këtë vërtetohet se Këshilli i KPM-së ka marrë këtë vendim në pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së KPM-së.

NK Krasniqi  
Naile Selimaj Krasniqi  
Shefe Ekzekutive



29.05.08  
datë